



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Dr. Sc. Ujkan Bajra

Kryetar i Këshillit Drejtues të UP-së

Nr. Prot.: 4/228
Datë: 5/12/2019

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në zbatim të nenit 17 pika 3 dhe nenit 22 pika 1.5 të Statutit të UP-së, në mbledhjen e mbajtur me datën 21.11.2019 merr këtë:

V E N D I M


- I. Obligohet Menaxhmenti i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", që brenda një afati të arsyeshëm kohor, të rishikoj të gjitha vendet e punës dhe të identifikoj nevojat reale për personel akademik dhe administrativ të Universitetit të Prishtinës, për vitin 2020.
- II. Në të gjitha njësitë e UP-së, të rishikohet fondi i orëve/normave dhe çdo angazhim tjetër i personelit akademik.
- III. Pa aprovimin paraprak të Këshillit Drejtues të UP-së, asnjë pozitë, funksion apo konkurs publik nuk mund të shpallet në media elektronike, të shkruara apo në ueb faqen e UP-së.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Këshilli Drejtues i Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", në zbatim të nenit 17 pika 3 dhe nenit 22 pika 1.5 të Statutit të UP-së, ka përgjegjësi të përgjithshme strategjike për funksionimin efektiv institucional të Universitetit. Në mënyrë që të sigurojë kushte të përshtatshme për veprimtarinë e qëndrueshme të Universitetit, sigurimi i resurseve dhe burimeve të nevojshme duhet të mbështet në planifikimin me kohë të kërkesave të Universitetit apo njësive akademike, përkatësisht organeve tjera të UP-së. Për të rritur transparencën e shpenzimit të parasë publike, në përputhje me kërkesat statutare dhe kornizën ligjore përkatëse, buxheti i UP-së dhe të njësive akademike duhet të sigurohet me kohe, sipas nevojave reale të Universitetit. Duke marrë parasysh respektimin e kërkesave ligjore si dhe koordinimin me institucionet tjera relevante për mbështetjen, rrjedhën dhe gjetjen e mënyrës së financimit, Këshilli Drejtues e konsideroi të arsyeshme marrjen e veprimeve konkrete, andaj nga ajo që u tha më lartë, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendim t'u dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Dekanëve të Njësive Akademike;
3. Sekretarit të Përgjithshëm të UP-së;
4. Shërbimit Financiar të UP-së;
5. Zyrës Ligjore të UP-së;
6. Asistentes së KD-së.



Këshilli Drejtues i UP-së

Ujkan Bajra
Dr. Sc. Ujkan Bajra – Kryesues